



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 349/Prot.
11

Berat, më 19/01/2022

V E N D I M
Nr. 48 datë 19/01/2022
PËR

PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2022, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË BERAT

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", vendimit nr.860 date 20.12.2021 "Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësivë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat", për vitin 2022 si edhe informacionin e Njësivë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira të krijuara në shërbimin civil në kategorinë e Ekzekutive , të ulët Drejtuese dhe të Mesme Drejtuese ,Kryetari i Bashkisë ,

V E N D O S I:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim në shërbimin civil, në administratën e Bashkisë Berat, për vitin 2022, pjesë e shërbimit civil do të jetë **11 (njëmbëdhjetë)** gjithsej sipas kategorive të mëposhtme :
 - a) Për kategorinë ekzekutive **7 (shtatë)**.
 - a.1. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçem në kategorinë ekzekutive janë si më poshtë :
 - Shkenca Shoqërore
 - Shkenca Ekonomike
 - Shkenca Juridike
 - Inxhinieri Ndertimi
 - a.2. Drejtoritë/ Sektorët ku planifikohen vendet vakante janë :
 - Sektori i Auditit të Brendshëm
 - Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
 - Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore
 - Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave, Transportit dhe Shërbimeve
 - Sektori i Pronave dhe Strehimit
 - Drejtoria Juridike
 - b) Për kategorinë e Ulët Drejtuese **1 (një)** pozicion
 - b.1. Drejtoritë ku planifikohet të shtohen vendet vakante janë :
 - Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

c) Për kategorinë e Mesme Drejtuese 3 (tre) pozicione

c.1. Drejtoria ku planifikohet të shtohen vendet vakante janë :

- Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve
- Drejtorinë e Drejtorisë së Turizmit dhe Aktiviteteve
- Drejtorinë e Drejtorisë së e Shërbimit Social

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Demo

